27 tetor 2026,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2026, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.05/ 2026-27 I KOMISIONIT TË GARAVE

I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar informacionin dhe kërkesën e paraqitur nga KB Kosovari lidhur me moskonstatimin dhe mosraportimin e përmbushjes së obligimit nga neni 11.4.5 i Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, për edicionin 2026/2027[1], në ndeshjen e xhiros së IV të Ligës së Parë të meshkujve, ndërmjet KB Istogu dhe KB Gjakova.

II. Komisioni i Garave, duke u bazuar në nenet 11.4.5 dhe 53.2 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, për edicionin 2026/2027, konstaton se në këtë rast ka pasur shkelje të Propozicioneve të Garave.

Konkretisht, ekipet e Ligës së Parë janë të obliguara që gjatë ndeshjes të sigurojnë gjithsej së paku 80 minuta lojë për lojtarët e lindur me te ri se viti 2005, përkatësisht për dy ose më shumë lojtarë që i përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 11.4.5.

Ky obligim nuk është evidentuar dhe nuk është pasqyruar në mënyrë të duhur në raportin e ndeshjes nga ana e vëzhguesit.

III. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe të provave materiale, përkatësisht raportit të ndeshjes dhe raportit të statistikave të ndeshjes, Komisioni i Garave vlerëson se provat e paraqitura janë të mjaftueshme për shqyrtimin e rastit dhe vendos si në vijim:

1. **KB Istogu**, në përputhje me nenin 11.4.5 të Propozicioneve të Garave, dënohet me gjobë në shumën prej **500 (pesëqind) eurosh**.

[1] Çdo ekip duhet t'i ketë 7 lojtarë të lindur më 2005 ose më të rinj në Listën Paraqitëse nëse ka të paraqitur 12 lojtarë, 7 lojtarë nëse ka të paraqitur 11 lojtarë dhe 7 lojtarë nëse ka të paraqitur 10 lojtarë. Ekipet e Ligës se Parë janë të OBLIGUARA që në total të kenë 80 minuta në lojë lojtarët (2 lojtarë e më shumë) e lindur më të ri se viti 2005. Në rast të mosrespektimit të këtij kriteri për herë të parë, klubi dënohet me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro. Ndërkaq, në rast të përsëritjes së mosrespektimit, klubi dënohet me gjobë në shumën prej 1,000 (një mijë) euro, ndërsa trajneri i ekipit pezullohet për dy (2) ndeshjet e ardhshme.

ProCredit Bank TEB ART MOTION kujtesa SAVA INSURANCE GROUP MALL automita RUGOVE
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com
rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria
Prishtina 10000, Republika e Kosovës

2. **Vëzhguesi i ndeshjes, Mehmet Xhemajli**, në përputhje me nenin 53.2 të Propozicioneve të Garave, dënohet me **mosdelegim në dy (2) ndeshjet e radhës**, në të gjitha garat e edicionit 2026/2027.

IV. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit të tij.

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur Vendimin Nr. 05/2026-27, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

a) Komisioni i Garave, në bazë të raporteve të ndeshjeve të dërguara nga vëzhguesit, ka përpiluar Informatorin nr. 04/2026-27 Liga e Parë Meshkujt. Nga shqyrtimi i raportit të ndeshjes ndërmjet KB Istogu dhe KB Gjakova, është konstatuar se vëzhguesi i ndeshjes nuk e ka pasqyruar gjendjen reale lidhur me përmbushjen e obligimeve të përcaktuara në Propozicionet e Garave. Konkretisht, KB Istogu nuk e ka përmbushur obligimin që lojtarët e lindur më të rinj se viti 2005, përkatësisht dy ose më shumë lojtarë, të kenë gjithsej 80 minuta lojë. Kjo rrethanë nuk është evidentuar në raportin e ndeshjes, duke rezultuar në paraqitje joobjektive të fakteve dhe mosraportim të gjendjes reale.

b) Komisioni i Garave ka konstatuar se gjatë ndeshjes janë evidentuar shkelje të dispozitave të përcaktuara në Propozicionet e Garave. Në mënyrë të veçantë, është konstatuar se KB Istogu nuk e ka përmbushur obligimin që lojtarët e lindur më të rinj se viti 2005, përkatësisht dy ose më shumë lojtarë, të kenë gjithsej 80 minuta lojë, ashtu siç parashihet për ekipet e Ligës së Parë.

Për më tepër, kjo shkelje nuk është evidentuar dhe nuk është pasqyruar në mënyrë të saktë në raportin e ndeshjes nga ana e vëzhguesit. Këto mangësi përbëjnë mospërmbushje të detyrave të vëzhguesit në raportimin objektiv të ngjarjeve dhe zbatimin e dispozitave përkatëse të Propozicioneve të Garave. Mosparaqitja e gjendjes reale në raport ka cenuar saktësinë dhe objektivitetin e dokumentimit zyrtar të ndeshjes.

c) Andaj, bazuar në faktet e konstatuara, provat materiale të shqyrtuara dhe dispozitat përkatëse të Propozicioneve të Garave, Komisioni i Garave ka vendosur që, siç përcaktohet në dispozitivin e këtij vendimi:

- **KB Istogu** të dënohet me gjobë në shumën prej **500 (pesëqind) eurosh**.
- **Vëzhguesi i ndeshjes, Mehmet Xhemajli**, të ndëshkohet me mosdelegim në **dy (2) ndeshjet e radhës**, në të gjitha garat e edicionit 2026/2027.

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com
rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria
Prishtina 10000, Republika e Kosovës

Komisioni i Garave:

Arianit Shala	Armend Hamiti	Ismet Ferati
Anëtar	Kryetar	Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE: *Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2026/2027, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.*

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com
rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria
Prishtina 10000, Republika e Kosovës